



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 08, Datë 15.01.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “INFO-TELECOM” SH.P.K. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.01.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 133 prot., datë 13.01.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “INFO-telecom” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “INFO-telecom” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.06.2021, me afat licence deri më 24.06.2026.
- Në nenin 16, pika 1, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 491 Seria T21, është 24.06.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 24.12.2025.
- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e saj nr. 99 prot., datë 23.12.2025, e cila është protokolluar në ERE, me nr. 2984/1 prot., datë 29.12.2025. Gjithashtu, rezulton se pagesa për rinovimin e licencës është kryer në datën 18.12.2025, pra konstatohet se shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të Rregullores.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se shoqëria duhet të sqarojë/plotësojë dhe sa vijon:
 - *deklaratën e kërkuar në gërmën “c” të Shtojcës 1 të rregullores dhe autorizimin për përfaqësuesin ligjor;*
 - *strukturën organizative aktuale;*
 - *parashikimin e sasisë së energjisë që do të tregtojë 5 vitet e ardhshme të ushtrimit të aktivitetit, plotësimin e planit të biznesit e po ashtu dedikimin e mbështetjes financiare përkatëse.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 491, Seria T21, të shoqërisë “INFO-telecom” sh.p.k., për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.06.2021.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “INFO-telecom” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI